



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:069751
Datë: 13.07.2021
Numri i dokumentit: 01986887

C.nr.991/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari Habib Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses M.A., të cilën e përfaqëson av.Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në çështjen juridike kërkesa për kompensimin e shpërblimit jubilar, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia e paditëses M.A., ashtu që **DETYROHET** e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në emër të shpërblimit jubilar për 14 (katëmbëdhjetë) vjet përvojë pune, t'i paguaj paditëses 50 % të një page dhe atë shumën prej 615.66 € (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive afatit prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do të ketë karakterin e titullit ekzekutiv dhe mund të përmbrohet menjëherë.

II. REFUZOHET kërkesa e paditëses për shpenzime të procedurës, si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Paditësja M.A., përmes të autorizuarit së tij av. Leutrim Ademi, më datë 16 qershor 2020 në këtë gjykatë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura-Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim, që ta kompensoj paditësen në emër të pagës jubilarë.

Lidhur me këtë, gjykata ka caktuar seancën gjyqësore më 24 shkurt 2021, në të cilën përfaqësuesi e të paditurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, duke mbetur pranë përgjigjes në padi.

Paraprakisht e paditura, përmes përgjigjes në padi të datës 26 tetor 2020, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar mes tjerash se sa i përket kërkesës për shpenzime të ushqimit e paditëses nuk gjen mbështetje, pasi që kontrata kolektive e datës 18 prill 2017 e nënshkruar mes SBASHK-ut dhe MASHT-it, ka përcaktuar edhe mundësinë financiare.

Në fakt, procedura gjyqësore gjatë seancës gjyqësore të datës 24 shkurt 2021, ishte zhvilluar për kërkesën e paditëses për kompensim të shpenzimeve, gjë që gjatë seancës i autorizuari i paditëses me parashtrësë kishte bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura që t'i paguaj paditëses shumën prej 1.270 € për 635 ditë pune dhe si rrjedhojë, e paditura nuk i kishte asnjë nga provat e paditëses, e që gjykata pastaj e kishte konstatuar të mbyllur shqyrtimin gjyqësorë.

Mirëpo, me rastin e përpilimit të vendimit meritor, gjykata ka vërejtur se padia e paditëses në raport me përfaqësimin e të autorizuarit të saj, në seancën gjyqësore të datës 24 shkurt 2021, kishte dallime, që do të thotë se padia e paditëses ka qenë dhe është për kompensim të shpenzimit jubilar, ndërsa i autorizuari i paditëses ka mbetur pranë kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit, gjë që edhe precizimin e kërkesëpadisë e kishte bërë si të tillë.

Lidhur me këtë, gjykata me të vërejtur një situatë të tillë ka vendosur që ta caktoj seancën gjyqësorë më datë 2 prill 2021 në të cilën është marrë aktvendim procedural, me të cilin është rihapur procedura kontestimore, duke e obliguar paditësen që të deklarohej rreth kërkesës së saj, e që pastaj paditësja, përmes të autorizuarit të saj ka mbetur pranë padisë bazë që kishte të bënte me kompensimin e pagës jubilarë. Në këtë drejtim gjykata në të njëjtën seancë gjyqësore e ka obliguar paditësen që në afat prej 7 dite të bëjë precizimin e kërkesëpadisë. Paditësja, përmes të autorizuarit të saj me parashtrësën e datës 13 prill 2021, e ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar që të kompensohet në emër të shpërblimit jubilar për 50 % të një page në lartësi prej 615.66 €. Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në lartësi prej 260 €, dhe atë për përpilim të padisë 104 €, për pjesëmarrje në seancë gjyqësore 135 € dhe për taksë gjyqësore 21 €.

Gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e pagës jubilarë është e bazuar, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas kësaj çështje, mund të lind pyetja se kjo çështje është derivat i mbajtjes së seancës gjyqësore apo duhet vlerësuar se është vendosur jashtë seance gjyqësore nën frymën e dispozitës së nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton *Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ka pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*

Në seancën gjyqësore të datës 2 prill 2021 gjykata e ka obliguar paditësen që në afat prej 7 ditëve ti dorëzojë gjykatës padinë në mënyrë të precizuar.

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj me parashtrësën e datës 13 prill 2021, e ka precizuar kërkesën, lidhur me lartësinë e saj, duke kërkuar shumë më siç është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e kësaj, gjykata ka vendosur që kjo çështje të përfundojë pa caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, pasi që sipas përgjigjes në padi, nuk ka rezultuar se në mes palëve të jetë kontestuese gjendja faktike, përveç se e paditura e ka kundërshtuar padinë e paditëses në kuptimin e bazës juridike, që do të thotë se bazuar në shkresat lëndës si: lista e stafit akademik-përvoja e punës për jubilarë dhe listat e pagave, rezulton se paditësja në kohën kur ka paraqitur padi ka pasur përvojë pune 14 (katërmëdhjetë vjeçare) e që sipas vlerësimit të gjykatës, kërkesëpadia e paditëses bazohet në kontratën kolektive të datës 18 prill 2017 e nënshkruar mes MASHT-it dhe SBASHK-ut. Andaj në këtë kuptim, paditësja me provat e prezantuara në padi e ka bërë të besueshëm kërkesëpadinë e saj, e që rrjedhimisht është vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket pikës II të dispozitivit, gjykata ka vendosur që kërkesa e paditëses për shpenzime të procedurës është e pa bazuar, sepse sipas thënieve të përfaqësuesit të paditurës gjatë seancës gjyqësore të datës 2 prill 2021 paditësja paraprakisht kishte paraqitur padi pranë kësaj gjykate për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit e që kjo gjykatë ka vendosur sipas vendimit C.nr.951/20 e që ky fakt nuk është kundërshtuar nga paditësja, gjë që për gjykatën konsiderohet fakt i vërtetuar.

Lidhur me këtë, lind pyetja, a ka mundur paditësja që krahas kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit të paraqesë padi-kërkesë edhe për kompensimin e shpërblimit jubilar? Bazuar në shkresat e lëndës, nuk rezulton se paditësja e ka pasur të pamundur që në të njëjtën kohë të ushtrojë dy kërkesa me një padi. Andaj mbi këtë arsye, gjykata ka vendosur që kërkesën e paditëses për shpenzime të procedurës ta refuzoj si të pa bazuar.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

C.nr.991/20, me datën 13 korrik 2021

Gjyqtari

Habib Ze qiri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 (shtatë) dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.